



30.04.2026

THIRRJE PUBLIKE PËR PRAKTIKANTË

Ministria për Komunitete dhe Kthim shpall thirrje publike për aplikimin e kandidatëve për pjesëmarrje në programin “**Praktikë dhe Perspektivë**”, i cili realizohet në kuadër të projektit të orientuar në përmirësimin e punësueshmërisë së pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, me fokus të veçantë në përfshirjen e grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara.

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është angazhimi i praktikantëve të cilët përmes punës praktike, trajnimeve profesionale dhe mbështetjes nga mentorët do të fitojnë aftësitë e nevojshme për përfshirje në tregun e punës, në përputhje me qëllimet e përgjithshme të projektit dhe misionin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që nënkupton krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm, përmirësimin e pozitës së komuniteteve dhe integrimin e tyre të plotë përmes mundësive të barabarta, shërbimeve efikase dhe pranisë së vazhdueshme institucionale.

1. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS

Programi i praktikës synon:

- të kontribuojë në rritjen e nivelit të punësueshmërisë së komuniteteve jo-shumicë;
- të forcojë kapacitetet e grave, të rinjve dhe personave me aftësi të veçanta përmes zhvillimit profesional;
- të përmirësojë kompetencat praktike dhe njohuritë profesionale;
- të mbështesë grupet e marginalizuara në procesin e integritit në tregun e punës;
- të sigurojë përfshirje të barabartë të kandidatëve nga të gjitha rajonet e Kosovës.

2. E DREJTA E PJESËMARRJES

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët që plotësojnë këto kushte:

- Janë pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë që jetojnë në Kosovë;
- Mosha nuk është kriter kufizues. Programi është i hapur për të gjithë të interesuarit, me përparësi për gratë, të rinjtë dhe grupet e cenueshme;
- Tregojnë interes për punë praktike dhe zhvillim profesional;



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада/ Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of
Communities and Return*

- Janë të gatshëm të marrin pjesë në programin e praktikës në një kohëzgjatje minimale prej tre (3) muajsh, me mundësi vazhdimi në varësi të rezultateve të arritura dhe mjeteve financiare të disponueshme të Ministrisë.
- Kanë njohuri dhe aftësi bazike për aktivitetet (arsimimi i mesëm apo i lartë është i dëshirueshëm, por jo i detyrueshëm).

3. FUSHAT E PRAKTIKËS

Gjatë zbatimit të programit të praktikës, praktikantët do të marrin pjesë në një sërë trajnimesh të strukturuar dhe të vazhdueshme, të orientuara drejt forcimit të kompetencave të tyre profesionale. Përmes këtyre aktiviteteve, ata do të aftësohen për pjesëmarrje aktive në tregun e punës, si dhe për zhvillimin e aftësive kyçe të nevojshme për vetëpunësim potencial.

Programi i praktikës përfshin aktivitete të orientuara në përmirësimin e punësueshmërisë së pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë përmes fushave kryesore në vijim:

1. **Praktika profesionale** – angazhimi i praktikantëve në institucione, organizata dhe sektorin privat me qëllim të fitimit të njohurive praktike dhe përvojës së punës;
2. **Zhvillimi i aftësive të buta dhe biznesore** – organizimi i trajnimeve që përfshijnë komunikimin, punën në ekip, sjelljen profesionale, si dhe aftësitë bazë të biznesit dhe sipërmarrjes;
3. **Trajnime zanatçare dhe profesionale** – aftësimi në fusha të ndryshme të zanateve (p.sh. parukeri, rrobaqepësi, zdrukthëtari, automekanikë dhe shërbime të tjera), me mundësi angazhimi praktik;
4. **Rrjetëzimi profesional** – lidhja e pjesëmarrësve me punëdhënës, institucione dhe aktorë relevantë me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe rritjes së mundësive për punësim;
5. **Përfshirja e barabartë dhe mbulimi rajonal** – zbatimi i aktiviteteve në të gjitha rajonet e Kosovës, me fokus të veçantë në përfshirjen e grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara.

4. KOMPENSIMI DHE KUSHTET

• **Shuma minimale e kompensimit financiar** që çdo praktikant përfiton është 500 euro në muaj, në përputhje me rregullat e thirrjes dhe dispozitat ligjore në fuqi.

• **Praktika realizohet** në kohëzgjatje prej tre muajsh, me respektim të plotë të procedurave të punës së organizatës pritëse.



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада/ Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of
Communities and Return*

• **Praktikantët do të kenë mbështetje mentorimi**, udhëzim profesional, pjesëmarrje në trajnime dhe qasje në rrjetin profesional të bashkëpunëtorëve.

5. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Aplikimin për stazh;
- Kopje të letërnjoftimit;
- Vërtetim për llogari bankare aktive;
- Kopje diplome dhe CV (opsionale, por e preferuar).

Aplikimet e paplota nuk do të shqyrtohen.

6. MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikimet dorëzohen vetëm personalisht në zyrat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në rrugën Nënë Tereza, PB. 12000, në Fushë Kosovë.

Aplikimet fillojnë të hënën, më **4 maj 2026**, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është më **19 maj 2026, deri në orën 15:00**.